




Pranuar / Dorezuar Punë/Pradato Received/Delivered	26 - 11 2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOC	5697/2021		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.840/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtar dhe Valentina Kaçandolli Bektashi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.840/2021 të datës 30.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

kundër Vendimi KA.nr.44/2021 me numër të protokollit 09/1432 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.840/2021 e datës 30.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.44/2021 me numër të protokollit 09/1432 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 20.05.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për vendin e punës “Zyrtar për të Hyra Gjyqësore”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi.

I pa kënaqur me njoftimin e datës 29.07.2021 me numër të protokollit 03/1324 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatës, ankuesi me datë 27.08.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 01.09.2021 me numër të protokollit 09/14325 merr vendimin KA.nr.44/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit dhe mbetet në fuqi njoftimi për përzgjedhje përfundimtare me numër 03/1324 i publikuar me datë 27.07.2021 për pozitën “Zyrtar për të Hyra Gjyqësore” i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimi KA.nr.44/2021 me numër të protokollit 09/1432 të datës 01.09.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 30.09.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 4847/2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2021, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 14.10.2021 ka përcjell dokumentacionin e kërkuar me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 30.09.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e ankuesit e datës 27.08.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi KA.nr.44/2021 i datës 01.09.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Konkursi i jashtëm me numër 03/2021 i datës 20.05.2021; Renditja e kandidatëve në testin me shkrim e datës 21.07.2021; Njoftimi për përgjedhje përfundimtare e datës 29.07.2021; Fletëkthesa mbi pranimin e Vendimit me numër të protokollit KA 09/1432; Propozimi për emërimin e kandidatit të rekomanduar i datës 29.07.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e datës 23.07.2021; Përcaktimi i kriterëve për përfshirje në listën e ngushtë; Raporti finali rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 23.07.2021; Pyetjet nga testi me gojë; Regjistri i Aplikacioneve të Pranuar; Deklarata për mos ekzistimin e konflikt të interesit e datës 15.07.2021 për emërimin e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve i datës 09.07.2021; Propozimi për emërimin e KPSHC-së; Vlerësimi i testit me shkrim i datës 19.07.2021 për bashkangjitur për përgaditjen profesionale dhe të përvojës së punës; Testi me shkrim për bashkangjitur për përgaditjen profesionale dhe të përvojës së punës; Testi me shkrim për bashkangjitur për përgaditjen profesionale, përvojën e punës dhe certifikatat e trajnimeve si dhe përgjigjia në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimore të ankuesit i cili ka kundërshtuar përzgjedhjen përfundimtare të kandidatës për vendin e punës "Zyrtar për të Hyra Gjyqësore".

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit nuk qëndron, pasi që sipas konkursit të datës 20.05.2021 kriteret kualifikuese për vendin e punës "Zyrtar për të Hyra Gjyqësore", kanë qenë:

- *Diplomë universitare: në lëminë ekonomike;*
- *Minimumi 2 vite përvojë punë profesionale në administrim të buxhetit dhe financave, etj.*



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave dëshmime për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitur në dosjen e kandidatës së përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në bazë të nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë që paragrafi 1 i këtij neni përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se:

Kandidatja e përzgjedhur _____ posedon Diplomë Universitare me numer 4296 të lëshuar nga Universiteti i Prishtines me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin Ekonomik me datë 21.09.2011 dhe mori titullin Bachelor për Banka, Financa dhe Kontabilitet, si dhe me përvojë të punës sipas Vertetimit të datës 30.12.2013 lëshuar nga Komuna e Prishtinws me te cilën dëshmohet se ka punuar si praktikante ne ne Drejtorine e Zhvillimit Lokal nga data 01.02.2013 deri me date 30.12.2013 si dhe Vertetimit të leshuar nga Kompania BEST Solution SHPK me te ciln dëshmohet se ka qene e punesuar nga data 20.10.2017 deri me date 31.12.2020 në pozitën 'Financiere.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës në listë të ngushtë ka përfshirë edhe ankuesin dhe kandidaten e përzgjedhur sepse i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit të datës 20.05.2021.

Kolegji i Këshillit për shqyrtimin e ankesave, nga provat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga organi i punësimit ka konstatuar se kandidatja e përzgjedhur _____ nga testimi me shkrim dhe me gojë ka realizuar gjithsej 416.75 pikë andaj në shërbimin civil emërohen kandidatët që kanë numërin më të madh të pikëve sipas nenit 40 paragrafit 1 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë"*, po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton që procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim me nenin 3 paragrafin 9, nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mosdiskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe dispozitave të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit sa i përket të drejtave të veçanta të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe që është përgjegjësi e shtetit që të ndërmerret të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur komunitetin jo shumicë ndaj veprimeve diskriminuese, Kolegji ka konstatuar se pretendimi i tillë ankimor i ankuesit nuk është i bazuar



sepse organi i punësismit me rastin e shpalljes së konkursit të jashtëm me datë 20.05.2021 ka ofruar mundësi të barabrata për të gjithë shtetasit e Kosovës, pa dallim gjinie dhe ka mirëpritur të gjitha aplikacionet e kandidatëve nga të gjitha komunitetet jo shumicë andaj Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se: *"2. Komuniteti dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë në përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil në organet e administratës publike dhe qendore dhe lokale; 3. Në kuadër të shërbimit civil në institucionet e nivelit qendror minimumi 10% e posteve duhet të rezervohen për personat të cilat u përkasin komuniteteve të cilët nuk janë shumicë në Kosovë dhe që i përmbushin kriteret specifike të punësimit. Në nivelin komunal për antarët e kualifikuar të komuniteteve që nuk janë shumicë në komunë, dotë jetë i rezervuar numri i vendeve të punës në pajtim me përfaqësimin proporcional të komuniteteve të komunës së dhënë"* rrjedhimisht për plotësimin e këtij neni Rregullorja Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil në nenin 22 paragrafit 3 ka përcaktuar se: *"Nëse pas ditës së fundit për pranimin e aplikacioneve nuk është arritur pranimi i një numri të balancuar të aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor, afati për pranimin e aplikacioneve zgjatet për shtatë (7) ditë kalendarike dhe publikohet nga Njësia e Personelit"*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.44/2021 me numër të protokollit 09/1432 të datës 01.09.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqëses së Personelit në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Arkivit të Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.840/2021

Valentina Kaçandolli Bekteshi

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit